



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

ZYRA E KRYEMINISTRIT  
OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA

AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE  
AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA / AGENCY OF GENDER EQUALITY

# **PROFILI GJINOR I KOSOVËS**

Prishtinë 2008



## **Parathënie dhe falënderime**

Profili Gjinator i Kosovës është hartuar në bazë të raporteve dhe studimeve ekzistuese. Megjithatë, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), e cila ka ndërmarrë këtë iniciativë, beson se paraqet një punë kompakte dhe të vlefshme për të gjithë që punojnë në këtë fushë dhe shpresojmë se do të shfrytëzohet gjerësisht.

Shfrytëzuesit inkurajohen t'i japin komente ose të dhëna shtesë, të cilat do të pasqyrohen në publikimet e mëvonshme.

Agjencia dëshiron të falënderojë të gjithë kolegët që kanë dhënë kontribut përmes komenteve në këtë draft.

Gjithashtu, Agjencia falënderon Projektin e UNDP për Ndërtimin e Kapaciteteve për Integrim Evropian (CBEI), i cili ka mbështetur këtë dokument.

Nënshkrimi

Shqipe Krasniqi

KE/ABGJ



## Akronimet

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore
MFGJ	Masat për Fuqizim Gjinor
IZHGJ	Indeksi Zhvillimor Gjinor
GDP/BPV	Bruto Produkti Vendor
IZHNJ	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
KFOR	Forca e Përkohshme e Sigurisë në Kosovë
IGK	Iniciativa e Grave të Kosovës
LGK	Lobi i Grave të Kosovës
RRGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetë-Qeverisëse të Kosovës
RAE	Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë
EKBK	Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Kosovë
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë



# PROFILI GJINOR I KOSOVËS

## Lokacioni, Popullata dhe Demografia

Kosova është një shtet<sup>1</sup> i vogël me një sipërfaqe prej 10,908 kilometra katrorë në qendër të Gadishullit Ballkanik, e kufizuar nga Serbia, Maqedonia, Shqipëria dhe Mali i Zi. Popullata vlerësohet të jetë mbi 2 milion banorë, me përqindje gjinore prej 102 meshkujve në çdo 100 femra. Jetëgjatësia shënon 71 vjet për femrat dhe 67 vjet për meshkujt.<sup>2</sup>

Kosova ka popullatën më të re në Evropë: më shumë se gjysma e popullit të Kosovës janë nën 25 vjet dhe rreth 21 përqind janë ndërmjet viteve 15 dhe 25. Shkalla e lindshmërisë është relativisht e lartë me një mesatare prej tre fëmijë për një nënë dhe me një shkallë më të lartë të fertilitetit në zonat rurale: 3,2 në krahasim me 2,3 fëmijë për një nënë. Në lindje, shkalla gjinore është në favor të meshkujve, për çdo 100 lindje vajzash ka 109 lindje meshkujsh<sup>3</sup>, kështu që ka më shumë foshnje meshkuj sesa femra.

Prej popullatës totale, rreth 92% janë shqiptarë, 5.3% serbë, 1.1% romë, 0.4% turqë dhe 1.2% të tjerë<sup>4</sup>. Edhe pse “Standardet për Kosovën”, një dokument i miratuar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara në vitin 2003<sup>5</sup> paraqet idenë e një

1 Kosova është shpallur shtet i pavarur, sovran dhe demokratik nga Parlamenti i Kosovës me dt. 17 shkurt 2008. Të dhënat në këtë publikim janë deri në vitin 2007.

2 [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk)

3 Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë; (2007)

4 Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, shkurt 2008. Statistikat i referohen vitit 2006

5 Në dhjetor 2003, Këshilli i Sigurimit të KB-ve miratoi “Standardet për Kosovën”, dokument që paraqet në detaje atë që është e nevojshme për të siguruar përputhshmëri të plotë me Rezolutën 1244. Gjashtë muaj më vonë, Plani për Zbatimin e Standardeve është hartuar për të definuar më qartë objektivat, detyrat dhe përgjegjësitë për institucionet e Kosovës në disa prej fushave kryesore.

Kosove multi-etnike me të drejta dhe liri të barabarta për të gjithë qytetarët pavarësisht nga përkatësia etnike, në praktikë ekziston një ndarje e konsiderueshme ndërmjet komuniteteve tjera me komunitetet RAE (romë, ashkali dhe egjiptian) si më të marginalizuarat.

Diaspora e Kosovës përbën një pjesë të konsiderueshme të popullatës së përgjithshme të Kosovës, edhe pse është vështirë të llogaritet numri saktësisht. Në bazë të vlerësimeve nga të dhënat e vitit 2000, diaspora përfshin mbi 586.000 persona<sup>6</sup>. Kanë qenë tri valë kryesore të emigrimit që kanë krijuar një diasporë të madhe. Para vitit 1989 emigrimi është bërë, kryesisht, për arsye ekonomike; ndërsa ndërmjet viteve 1989 dhe 1999 kushtet politike shkaktuan emigrimin. Faza e tretë ka qenë gjatë luftës së vitit 1999. Shumica e refugjatëve të vitit 1999 janë kthyer edhe pse një numër i konsiderueshëm nga komuniteti serb, rom e boshnjak kanë lëshuar vendin pas përfundimit të luftimeve, mirëpo çdo ditë e më shumë ka të rikthyer nga të gjitha komunitetet. Në përgjithësi, diaspora kosovare ka më shumë meshkuj sesa femra.

## **PASQYRA HISTORIKE**

Brenda ish-Jugosllavisë, Kosova ishte njësi federale, por për dallim nga Serbia ose Kroacia ishte krahinë e jo republikë. Popullata shumicë e shqiptarëve të Kosovës vazhdimisht kërkonte autonomi më të gjerë brenda Jugosllavisë Socialiste. Në bazë të kushtetutës së vitit 1974, Kosovës iu dha autonomi substanciale duke e bërë krahinë pothuaj të barabartë me republikat në aspektin e fuqisë dhe përfaqësimit në qeverinë Federale. Në bazë të Kushtetutës së vitit 1974 krahina kishte përfaqësim të drejtpërdrejt në ish- federatën e Jugosllavisë, mirëpo vetëm republikat e kishin të drejtën e vetë-vendosjes.

Që prej vitit 1981, popullata e Kosovës kërkoi avansimin e

6 Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, "Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-2006", Seria 4 - Statistikat e Popullsisë



pozitës së saj politiko-juridike dhe barazimin e statusit të saj me ish-republikat federale. Kjo kërkesë u shtyp me dhunë e represion nga aparati shtetëror serb dhe jugosllav. Gjatë viteve 1981-1989 nëpër duart e policisë serbe kanë kaluar mbi 200 mijë shqiptarë.<sup>7</sup> Këskesa për barazi me ish-republikat federale ishte e vazhdueshme dhe e përherëshme, deri në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë.

Që prej kohës së shpërbërjes së ish-federatës jugosllave, Kosova ka kërkuar liri, demokraci dhe vetëvendosje për të krijuar shtetin e vet të pavarur dhe sovran.

## HISTORIA POLITIKE E KOSOVËS GJATË KOHËVE TË FUNDIT

### 3. Arbitrazhi<sup>8</sup>

Në anën tjetër, Serbia e udhëhequr nga presidenti Milosheviç e zhveshi Kosovën nga shumë fuqi në vitin 1989 duke suprimuar me dhunë autonominë e Kosovës me pretekst të mbrojtjes së serbëve të Kosovës nga shqiptarët e Kosovës. Millosheviçi

7 Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ)

8 2 Në bazë të Kushtetutës së vitit 1974, Krahina Socialiste Autonome e Kosovës kishte të drejtë të miratimit dhe ndryshimit të kushtetutës së saj, të miratojë ligje, të ushtrojë funksione juridiko-kushtetuese dhe gjykatën kushtetuese, gjykatën supreme, të drejtën në ndryshimin e territorit të vet, parlamentin e vet dhe kryetarin për ta përfaqësuar në nivel federal etj; për më shumë shih shkresën 2, nenet 301, 349, 372, 390.

3 Shih Seksionin 1 të Preambulës së Kushtetutës së Republikës Socialiste të Serbisë të vitit 1974, Gazeta Zyrtare, Beograd, 1974, dhe Seksionin 1 të Preambulës së Kushtetutës së Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës, 1974, Gazeta Zyrtare, Beograd, 1974.

4 Shih Opinionin 1 të Konferencës për Jugosllavinë, Komisioni Arbitrar, 1259-1261, në Rancharan, B.G. (ed) Konferenca Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë: Dokumentet Zyrtare, Hagë: Kluwer Law International, 1997. Rreth interpretimit të këtyre opinionëve për Kosovën shih Zejnullah Gruda, "Disa parime kyçe për një Zgjidhje të Qëndrueshme për Kosovën: Uti Possidetis, Parimi etnik dhe vetëvendosja", 80 Chi.-Kent L. Rev.- (2005), 353-394 dhe Enver Hasani, Vetë-Vendosja, Integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar Rasti i Jugosllavisë, Vjenë: PfP Consortium Study Group "Stabiliteti Rajonal në Evropën Jug-Lindore, 2003.

ndërmori një regjim të represionit dhe të përjashtimit të shqiptarëve përmes të cilit shqiptarëve iu cenuan pothuaj të gjitha të drejtat dhe liritë; iu cenua e drejta e arsimit, punësimit, shërbimeve publike, duke detyruar, në këtë mënyrë, shqiptarët e Kosovës të themelojnë sistemet paralele. Gjatë kohës së regjimit të Millosheviqit, prej vitit 1989 e deri në qershor të vitit 1998 nëpër duart e policisë serbe kanë kaluar mbi 500 mijë shqiptarë. Kjo shifër paraqet vetëm numrin në total, sepse nga ky numër, me dhjetëra apo qindra shqiptarë kanë kaluar më tepër se dy herë nëpër aparatin shtetëror të dhunës e represionit.<sup>9</sup>

Represioni i rritur shkaktoi reagimin dhe luftën popullit shqiptar të Kosovës të rreshtuar nën emblemen e UÇK- së për çlirim nga okupimi serb, që rezultoi me ndërhyrjen ushtarake të NATO-së në vitin 1999.

Që nga viti 1999, Kosova ka statusin e protektoratit ndërkombëtar në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe është e qeverisur nga administrata ndërkombëtare e njohur si UNMIK. Autoriteti përfundimtar legjislativ dhe ekzekutiv është i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve (PSSP). Aspektet e sigurisë menaxhohen nga forcat ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë, të njohura si KFOR. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB-ve ka imponuar largimin e trupave serbe.

## **QEVERIA DHE ADMINISTRATA**

Është miratuar një Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9 (2001)) e cila ndan përgjegjësitë ndërmjet UNMIK-ut dhe institucioneve të përkohshme të vetë-qeverisjes (IPVQ) për të zhvilluar qeverisjen deri në arritjen e një zgjidhjeje finale.

Korniza Kushtetuese pasqyron dhe respekton Kapitujt kryesor të KB-ve, përfshirë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas (CEDAW).

---

<sup>9</sup> Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ)

Institucionet kryesore të Përkohshme Vetëqeverisëse janë:

- Kuvendi
- Kryetari i Kosovës
- Qeveria
- Gjykatat
- Zyra e Ombudspersonit

Zgjedhjet për Kuvendin parlamentar janë mbajtur tri herë, në vitin 2001 dhe 2004 dhe në nëntor të vitit 2007. Bartja e kompetencave të qeveritë lokale ka filluar me zgjedhjet lokale për kuvendet komunale të mbajtura në vitin 2000 dhe 2002 dhe 2007.

## **PARLAMENTI**

Sistemi aktual zgjedhor është sistem i përfaqësimit proporcional me lista të hapura. Kuvendi ka 120 ulëse, prej tyre 20 janë të rezervuara për komunitetet etnike joshqiptare. Sistemi, gjithashtu, kërkon që femrat të përbëjnë një të tretën e listës së kandidatëve për secilën parti, ose që çdo i treti kandidat të jetë femër. Përqindja e femrave në kuvendet komunale dhe në Kuvendin e Kosovës është më e larta në rajon, edhe më e lartë se në shumicën e vendeve të Evropës perëndimore, megjithatë në postet kryesore udhëheqëse përfaqësimi i femrave është ende i ulët.

Femrat vazhdojnë të kenë vështirësi për të hyrë në jetën politike pavarësisht prej sistemit të kuotës, për shkak të mbizotërimit të disa formave stereotipe, të cilat i atribuojnë femrave vendin në fushën private dhe shtëpiake. Kjo nënkupton që, edhe pse Kosova është e radhitur në vendin e 17 në aspektin e barazisë gjinore në vendimmarrje, çështjet gjinore nuk zënë vend shumë të lartë në agjendat politike dhe femrat politike nuk janë edhe aq dukshme.

Duhet të theksohet se prezenca e femrave në organet legjislative

pasqyron vetëm kërkesat ligjore për përfaqësim gjinor në listat elektorale, me 37 prej 120 ulëseve në Kuvendin e Kosovës, ose shprehur në përqindje 30.83%, ndërsa 30.91% të të gjitha ulëseve të kuvendeve komunale janë të zëna nga gratë<sup>10</sup>. Vetëm 2 prej 13 komisioneve parlamentare janë të udhëhequra nga femrat.

Në procesin e përafrimit të Republikës së Kosovës me anëtarësimin në BE dhe përafrimin e legjislacionit me Acquis communautaire, Parlamenti, në kapacitetin e tij si pushtet legjislativ, përfaqëson një faktor të rëndësishëm në përcaktimin e dinamikës së përmbushjes së standardeve të domosdoshme për hyrje në BE.

## QEVERIA

Qeveria e Republikës së Kosovës është organi kompetent për koordinimin e autoriteteve të administratës publike dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre. Qeveria dhe anëtarët e saj janë të përgjegjshëm për veprimet e tyre para Kuvendit të Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës ka 17 Ministri<sup>11</sup>:

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Ministria e Energjisë dhe Minierave
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
- Ministria e Pushtetit Lokal

10 Në mungesë të informatave, në këtë përqindje nuk janë përfshirë të dhënat nga dy komuna të Kosovës: Mamusha dhe Dragashi. Përqindjen e ulëseve të kuvendeve komunale e ulin komunat e banuara me shumicë serbe, psh. Shtërpca 18%, sepse gjatë zgjedhjeve, komunat me shumicë serbe nuk kanë respektuar Rregulloren UNMIK-ut nr 2007/26 dhe 2007/27 mbi zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, përkatësisht Zgjedhjet Komunale në Kosovë (neni 6.6, përkatësisht 6.4). Ilustrimi më i mirë është Mitrovica: Mitrovica e Veriut 12.5%, (e banuar me shumicë serbe) dhe Mitrovica e Jugut me 34.14% (e banuar me shumicë shqiptare).

11 Ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës të dalura nga Zgjedhjet e Nëntorit të vitit 2007

- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria për Komunitete dhe Kthim
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Shërbimeve Publike
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente
- Ministria e Punëve të Jashtme
- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
- Ministria e Industrisë dhe Tregëtisë
- Ministria e Transportit dhe Postë - Telekomunikacionit dhe
- Ministria e Drejtësisë

## **GJYKATAT**

Sistemi i gjykatave të rregullta të Kosovës përbëhet nga 26 gjykata komunale, 5 gjykata qarku, Gjykata Komerciale e Kosovës, si dhe Gjykata Supreme.

Sistemi i gjykatave për kundërvajtje përfshin 26 gjykata komunale për kundërvajtje, si dhe Gjykata e Lartë për Kundërvajtje. Sipas statistikave të 2007-ës nga KGjK, gjyqësori ka pasur 322 pozita gjykatësi me 301 gjykatës në shërbim, duke përfshirë 13 në Gjykatën Supreme, 4 në Gjykatën Komerciale, 5 në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje, 49 gjyqtarë në gjykatat e qarkut, 141 në gjykatat komunale, si dhe 89 gjyqtarë në gjykatat për kundërvajtje.

Gjykata Supreme e Kosovës është organi më i lartë në sistemin e gjykatave të rregullta. Ajo funksionon si gjykatë apeli e shkallës së tretë në një numër të caktuar rastesh penale: dëgjon apelet kundër vendimeve nga gjykatat e qarkut prej apelit të

gjykatave komunale. Ajo gjithashtu dëgjon apele direkte në rastet që dalin në gjykata qarku, si dhe shërben si gjykatë e shkallës së parë për çështje të jashtëzakonshme dhe çështje tjera sipas ligjit (p.sh. konteste administrative).

Më herët është themeluar një Odë e Posaçme e Gjykatës Supreme, e cila përbëhet nga 2 gjykatës vendorë të Gjykatës Supreme të Kosovës si dhe tre gjyqtarë ndërkombëtarë, për të zgjidhur ankesat ndaj vendimeve të privatizimit nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

Qeveria e Kosovës, me vendimin Nr. 5/131, të datës 1 shkurt 2005, ka themeluar Zyrën për Barazi Gjinore si një organ special të Qeverisë së Kosovës, në përputhje me Nenin 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/18, të datës 7 qershor 2004 mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji Nr. 2004/2). Në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 03/2006, të datës 12 korrik 2006, Zyra për Barazi Gjinore, me 1 shtator 2006, u transformua në Agjencinë për Barazi Gjinore brenda Zyrës së Kryeministrit. Agjencia për Barazi Gjinore është themeluar si agjenci ekzekutive, e cila është përgjegjëse për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe meshkujve në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore, si faktori rëndësishëm për funksionimin e institucioneve demokratike.

Ngritja e numrit të femrave në pozita vendimmarrëse ka qenë dhe është prioritet i Qeverisë së Kosovës. Në bazë të të dhënave më të fundit nga Enti Statistikor i Kosovës, 38% të pozitave në nivel qendror qeveritar i takojnë femrave, ndërsa ky numër është i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë nëpër sektorë<sup>12</sup>. Në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal 43% të posteve vendimmarrëse i takojnë femrave, ndërsa në Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural femrat kanë përfaqësimit më të kufizuar me vetëm 12%.

---

12 Femrat dhe meshkujt në Kosovë, Enti Statistikor i Kosovës, 2007

## EKONOMIA

Kosova ka qenë, gjithmonë, pjesa më e varfër e ish-Jugosllavisë. Për shembull, në vitin 1988, BPV (GPD) për kokë banori në Kosovë ishte vetëm 67% të mesatares së Jugosllavisë në tërësi dhe vetëm 44% të mesatares së Sllovenisë dhe vetëm 74% të mesatares së Serbisë, pjesë e së cilës ishte Kosova. Me shpërbërjen progresive të Jugosllavisë, Kosova u bë edhe më e varfër me të ardhura për kokë banori prej 400\$ në vitin 1995.

Me përfundimin e luftës në vitin 1999, Kosova ka bërë progres në përmirësimin e infrastrukturës, ofrimin e shërbimeve publike dhe në ndërtimin e institucioneve shtetërore. Në vitin 2006, kanë filluar bisedimet për zgjidhjet e statusit të saj dhe ka filluar puna në Strategjinë dhe Planin Zhvillimor të Kosovës.

Ekonomia e Kosovës vazhdon të jetë e dobët. Pas një ngritje në vitet 2000 dhe 2001, ngritja e Bruto Produktit Vendor (GDP) ka qenë negativ në vitet 2002 dhe 2003 ndërsa në vitin 2004 arrin shifrën 4 % për të rënë vitin 2005 dhe për të osciluar me ngritje 3.0 % në vitin 2006.<sup>13</sup> Oscilimi vjen si pasojë e paaftësisë së burimeve vendore që të kompensojnë rënien e ndihmës nga jashtë. Inflacioni është i ulët, ndërsa buxheti ka pasur deficit për herë të parë në vitin 2004. Kosova ka deficite të jashtme të larta. Në vitin 2004, deficit i bilancit të mallrave dhe shërbimeve ishte afër 70% të BPV-së. Paratë e dërguara nga jashtë (Remitancat) nga kosovarët që jetojnë jashtë vendit vlerësohen të jenë rreth 13 përqind të BPV-së dhe ndihma e jashtme rreth 34 përqind të BPV-së.

Shumica e zhvillimit ekonomik, nga viti 1999, është bërë në fushën e tregtisë, shitjes me pakicë dhe sektorin e ndërtimit. Sektori privat, i shfaqur nga viti 1999, është kryesisht i shkallës së vogël. Sektori industrial vazhdon të jetë i dobët dhe furnizimi me energji elektrike mbetet i pasigurt dhe paraqet pengesën kryesore. Papunësia vazhdon të jetë e lartë, me rreth 40-50% të fuqisë punëtore.

UNMIK-u ka aplikuar një de-facto regjim tregtar të jashtëm dhe administratë doganore me 3 shtator 1999, kur ka vendosur

---

<sup>13</sup> Buletini Tremujor Makroekonomik, mars 2006 (IPVQ-MEF)

kontrollet kufitare doganore në Kosovë. Pastaj është miratuar edhe Rregullorja 2004/1. Të gjitha mallrat e importuara në Kosovë i nënshtrohen një tarifë doganore paushall prej 10% plus TVSH-ja (Tatimi i Vlerës së Shtuar) . Ky tatim mbledhet në pikat tatimore të vendosura në kufijtë e Kosovës, përfshirë ato ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Institucionet e Kosovës dhe UNMIK-u kanë nënshkruar Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë me Kroacinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Shqipërinë dhe Maqedoninë. Gjatë muajit dhjetor 2006, Kosova dhe të gjitha vendet e rajonit nënshkruan marrëveshjen e re jo bilaterale CEFTA 2006, e cila si një marrëveshje rajonale e tregtisë së lirë, integron të gjitha marrëveshjet ekzistuese dypalëshe të tregtisë së lirë ndërmjet vendeve të rajonit.

CEFTA është marrëveshje e tregtisë së lirë dhe përfshin tetë vende të rajonit: Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Serbinë, Bosnjën e Hercegovinën, Kroacinë dhe Moldavinë.

Për Kosovën, CEFTA 2006 rrit numrin e vendeve me marrëveshje të tregtisë së lirë, nga katër në shtatë shtete.

Maqedonia, tregu më i madh importues dhe eksportues i Kosovës (me mesatare prej 220 milion euro, përkatësisht 9 milion euro), pastaj vjen Serbia-Mali i Zi (111 milion dhe 5 milion euro), Gjermania dhe Turqia.

Euro është valuta zyrtare e Kosovës. Ekonomia është e penguar nga statusi i pazgjidhur ndërkombëtar i Kosovës, i cili e ka vështirësuar tërheqjen e investimeve dhe kredive. Dobësia ekonomike e Kosovës ka rezultuar me rritjen e ekonomisë së zezë ku kontrabandimi i karburanteve, duhanit dhe çimentos paraqesin mallrat kryesore. Përhapja e korrupsionit zyrtar dhe ndikimi i rritur i grupeve të krimit të organizuar ka shkaktuar shqetësime serioze ndërkombëtarisht. Kombet e Bashkuara kanë bërë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar prioritet të lartë, duke u zotuar për një qasje të “zero tolerancës”.

Rreth 45 për qind e popullsisë në Kosovë është e varfër, me një pjesë tjetër prej 18 për qind të rrezikuar nga varfëria<sup>14</sup>.

14 “Vlerësimi i varfërisë në Kosovë”, Vëllimi i I, 3 Tetor 2007, faqe 11.



Shkalla e femrave në tregun e punës është më e ulët sesa ajo e meshkujve që pasqyron, ndërmjet tjerash, prirjen e femrave për të vënë në rend të parë përgjegjësitë familjare dhe shtëpiake. Megjithatë, në nivelet më të larta të arsimimit, dallimet në pjesëmarrjen e meshkujve dhe femrave shënojnë rënie duke pasqyruar efektin barazues të arsimimit.

Ka dëshmi për dallime gjinore në vende të punës, si në aspektin vertikal ashtu edhe horizontal. Për dallim nga femrat, meshkujt kanë pozita më të larta, prandaj dhe më mirë të paguara. Meshkujt dominojnë në tregun e punës në fushat tradicionale mashkullore siç janë ndërtimtaria, transporti, bizneset e mëdha etj, derisa femrat janë më shumë të punësuar në të ashtuquajturit “sektorët e lehtë” siç janë telekomunikacioni, shërbimet sociale, arsimi dhe shëndetësia. Vetëm në disa kategori punuese (tregti, admistratë publike) mund të vërehet barazia gjinore, gjerësa statistikisht që pasqyrojnë raportin e të punësuarve oscillojnë sipas aktivitetit ekonomik, psh. në sektorin e buqësisë nga 100 persona 21 janë femra e 18 mashkuj, gjerësa në sektorin e shëndetësisë në 100 persona 15 janë femra e vetëm 3 mashkuj.<sup>15</sup>

Punësimi me orar të plotë është duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme për meshkuj dhe femra. Orari punues mesatar për femra dhe meshkuj në punësim me orar të plotë është 40 orë në javë.

Shkalla e papunësisë për femra të moshës 15-64 vjet është përafërsisht 60% në krahasim me shkallën e papunësisë për meshkuj që është 33%. Papunësia është më e larta në grup moshat e reja me 81% tek vajzat dhe femrat ndërmjet 15 dhe 24 vjet, dhe 64% te meshkujt e të njëjtit grup të moshës.

Ka dallime të mëdha në të hyra ndërmjet meshkujve dhe femrave në Kosovë. Meshkujt fitojnë tri herë (3.19) më shumë sesa femra (134 euro në krahasim me 42 euro në muaj). Ky dallim i madh në të hyra, ndërmjet meshkujve dhe femrave në Kosovë, reflektohet në BPV-në relativisht të ulët të Kosovës dhe në pozitat më pak të paguara për femra sesa meshkujt.

Edhe pse së paku formalisht, në sektorin publik nuk ka disavantazh ligjor në paga ndërmjet meshkujve dhe femrave,

---

Banka Botrore dhe Enti i Statistikës së Kosovës

15 Enti i Statistikës i Kosovës, shkurt 2007

femrat prapëseprapë janë të punësuar në pozita më të ulëta dhe, prandaj, më pak të paguara.

Dallimi i dytë i madh gjinor është në shkallët e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore. Pjesëmarrja e grave në fuqinë e paguar punëtore është gati sa gjysma e burrave. Në vite kjo përqindje është ulur nga 35 në 30 për gratë dhe nga 72 në 68 për burrat.

Shkalla e papunsisë për vitin 2006 shënon 62% për gratë, ndërsa për burrat 35%.<sup>16</sup>

Të hyrat e ekonomive familjare kosovare vijnë nga disa burime: nga puna, nga paratë e dërguara dhe nga mirëqenia sociale. Burimet e të hyrave për shumicën e ekonomive familjare është më e rëndësishmja me një mesatare prej 10% të të hyrave nga paratë e dërguara. Ekonomitë familjare të udhëhequra nga femrat kanë një shkallë më të shpeshtë të varfërisë të vlerësuar në 4%, edhe pse nuk duket të rritet më shumë.<sup>17</sup>

## ARSIMI

Trazirat politike të viteve '90 kanë pasur efekt negativ në arsim sikurse edhe në sistemet tjera.

Periudha pas vitit 1999 ka filluar me reformat e para për përmirësimin e situatës në çdo nivel të arsimit. Megjithatë, në përgjithësi, sektori ende nuk financohet sa duhet posaçërisht duke marrë parasysh rënien e shpejtë të fondeve nga donatorët e cila nuk është mbuluar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Pjesa më e madhe e buxhetit për sistemin arsimor shkon për paga dhe shpenzime tjera operative e jo në zhvillimin e këtij sektori.

Edhe Korniza Kushtetuese dhe Korniza e Planprogramit të Kosovës (2001) si dhe Strategjia për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë 2002-2007 qartë pohojnë që asnjë formë e diskriminimit, përfshirë atë gjinor, nuk lejohet. Megjithatë, është e qartë se janë disa zbrazëtira në fushën e arsimit.

---

16 "Gratë dhe Burrat në Kosovë", shkurt 2007, faqe 2 - ESK

17 Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë, Banka Botërore 2007 dhe ESK

Të dhënat në dispozicion sugjerojnë që përafërsisht 95% të popullatës relevante vijojnë arsimin primar të obligueshëm, edhe pse shkallët e regjistrimit janë më të larta për shqiptarët e serbët në krahasim me grupet tjera etnike.

Shqiptarët e Kosovës studiojnë me një mesatare prej 9.33 viteve prej tyre në aspektin gjinor meshkujt studiojnë dy vite më shumë se femrat. Analfabetizmi tek femrat (9%) dhe është tri herë më i lartë sesa te meshkujt shqiptarë të Kosovës. Brenda komunitetit të shqiptarëve të Kosovës, shkalla e regjistrimit në arsim fillor është e lartë, derisa në arsim të mesëm është pak më e dobët. Rreth 30% të femrave dhe 20% të meshkujve nuk regjistrohen. Rreth 9.7% të shqiptarëve të Kosovës vijojnë ose e kanë të përfunduar shkollimin e lartë ose universitetin.

Serbët e Kosovës zënë vendin më të lartë në indeksin arsimor. Në mesatare, ky grup kalon 10.61% në shkollim. Meshkujt serb të Kosovës studiojnë një vit më shumë sesa femrat. Shkalla e shkrim-leximit është mjaft e lartë në krahasim me pjesën tjetër të popullatës; vetëm 1% të meshkujve dhe 4% të femrave nuk kanë këto shkathtësi. Shkalla e regjistrimit në arsimin fillor është pak më e ulët te shqiptarët e Kosovës, me përafërsisht 5.5% të fëmijëve që nuk vijojnë shkollën fillore. Megjithatë, shkalla e regjistrimit në shkollën e mesme është më e lartë se për pjesën tjetër të popullatës, me rreth 15% të femrave dhe 12% të meshkujve që nuk vijojnë këtë nivel. Rreth 12.3% kanë të regjistruar ose të përfunduar universitetin ose shkollimin e lartë.

Boshnjakët, turqit dhe goranët vijnë pas shqiptarëve të Kosovës në indeksin arsimor.

Mesatarisht, ata studiojnë 8.61 vite, prej tyre meshkujt studiojnë dy vite më shumë se femrat. Shkalla e analfabetizmit është rreth 7% dhe ka shtrirje më të gjerë te femrat 12%, derisa te meshkujt është vetëm 1%. Edhe pse shkalla e vijimit të arsimit fillor është e lartë, arsimi i mesëm është një çështje që meriton t'i kushtohet vëmendje. Rreth 30% e këtij grupi nuk vijojnë shkollën e mesme dhe ky problem është më shumë i theksuar tek meshkujt. Vetëm 9% kanë ndjekur ose përfunduar shkollimin e lartë ose universitetin.

Komunitetet rom, egjiptian dhe ashkali janë më të paarsimuarat.

Më shumë se 16% të RAE nuk dinë shkrim-lexim. Analfabetizmi është më i shprehur te femrat RAE (25%) sesa te meshkujt me (8%). Meshkujt RAE studiojnë mesatarisht tetë vite ndërsa femrat 5.5 vite. Në përgjithësi, një e katërta e fëmijëve RAE nuk vijojnë arsimin fillor (31% të femrave dhe 19% të meshkujve). Situata është edhe më serioze sa i përket arsimit të mesëm, ku përafërsisht 78% të femrave dhe 62% të meshkujve nuk vijojnë mësimin.

Pothuaj se asnjë mashkull ose femër nga komunitetet RAE nuk kanë të kryer universitetin dhe vetëm 1.4% kanë vijuar ose të kryer shkollimin e lartë.

Shkalla e përgjithshme e analfabetizmit në Kosovë është 5.8%, që është relativisht e lartë për rajon dhe është e koncentruar në popullatën mbi 65 vjet dhe tek komunitetet RAE prej të cilëve 24.4% janë të klasifikuar si analfabet. Në aspektin e dallimeve të konsiderueshme gjinore, disa të dhëna sugjerojnë që rreth 9.5 përqind të femrave në moshat 16-19 vjet janë analfabete.

Shumica e braktisin shkollën në nivelin primar, posaçërisht në zonat rurale dhe kjo është më e theksuar për femrat sesa për meshkujt. Hulumentimet sugjerojnë që derisa në vitet e para të shkollimit numrat e meshkujve dhe të femrave janë pak a shumë të njëjtë në dy deri tri vitet e fundit të shkollimit primar, në veçanti shkollat në zonat rurale shkalla fillon të ulet. Në përgjithësi, më pak vajza sesa djem vazhdojnë shkollimin e mesëm.

Pritjet tradicionale sociale vënë theksin në regjistrim më të ulët dhe braktisje më të madhe të shkollës për femrat kosovare. Për më tepër, shpenzimet që shoqërojnë shkollimin (librat, transporti, etj) edhe më shumë e forcojnë prioritetin e dhënë djemve në zonat rurale. Gjithashtu, edhe në të kaluarën, shqetësimet rreth sigurisë kanë bërë të hezitojnë t'i lënë vajzat të shkojnë në shkollë përmes sigurisë shtëpiake.

Faktorët tjerë që ndikojnë në braktisje të dy grupet mund të jenë dështimi për të fituar shkathtësi të mjaftueshme të shkrim-leximit në nivelet e ulët për të vazhduar me arsim të mëtutjeshëm, si dhe mungesa e objekteve fizike joadekuate, të cilat shpeshherë kanë bërë që mësimi të zhvillohet në disa ndërrime.

Shkalla e përfshirjes në shkollim të mesëm tregon se, derisa shkalla e përgjithshme është duke u rritur, ka dallime të theksuara gjinore në këtë nivel. Për vitin shkollor 2003-2004, për shembull, 75% të atyre me të drejtë është regjistruar një përmirësim i konsiderueshëm në krahasim me regjistrimin e vitit shkollor 2000-2001 prej 59.5%. Megjithatë, shkalla e vajzave në krahasim me të djemve në këtë nivel është shumë më e ulët 0.79 në krahasim me 0.92. Situata për vajza të komuniteteve etnike minoritare mund të jetë edhe shumë më e ulët.

Duke marrë parasysh, zbrazëtinë gjinore në shkollimin e mesëm, meshkujt kanë më shumë gjasa që të vijojnë universitetin sesa femrat. Kjo qartazi ndikon në mundësitë e punësimit në të ardhmen për femra, përsirë punësimin në sektorin e arsimit.

Femrat janë të nën-përfaqësuara në aspektin e punësimit në arsim në përgjithësi, edhe pse në disa nivele pjesa e femrave është më e lartë sesa e meshkujve. Në nivelin e arsimit parashkollor, 56% të pozitave i takojnë femrave, ndërsa në nivelet e shkollimit të lartë vetëm 12% të posteve i takojnë femrave.

Gjithashtu, me sa duket femrat janë të nën-përfaqësuara në pozitat më të larta administrative dhe menaxheriale në sistemin arsimor edhe pse nuk ka të dhëna të freskëta.

Në aspektin e çështjeve kualitative është bërë punë interesante për konfirmimin e stereotipeve tradicionale gjinore përmes teksteve shkollore në përdorim në të gjitha nivelet e sistemit arsimor si dhe përmes sjelljes së stafit mësimdhënës ndaj djemve dhe vajzave në klasat e tyre<sup>18</sup>.

Arsimi profesional në Kosovë bëhet përmes tetë Qendrave Trajnuese Profesionale. Në vitin 2005, ato kanë shërbyer vetëm 4.000 persona, prej tyre një e treta femra. Në përgjithësi, kërkesa për trajnim profesional i tejkalon shumë shërbimet e ofruara.<sup>19</sup>

Ky sektor i sistemit arsimor, tradicionalisht, është koncentruar në shkathësitë e konsideruara si më të duhura për meshkuj dhe ka pasur pak, apo fare hiq, përpjekje për të ndryshuar stereotipet kulturore duke inkurajuar meshkujt dhe femrat në zonat neutrale tradicionale.

---

18 Revizioni i Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (2006)

19 Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë, UNDP (2006)

## SHËNDETËSIA

Edhe pse kujdesi shëndetësor ofrohet falas për të gjithë banorët e Kosovës, aktualisht nuk ka sigurime shëndetësore. Megjithatë, Ministria e Shëndetësisë është në proces të përgatitjes së infrastrukturës legjislative, e cila pritet të zbatohet në vitin 2008.

Udhëzimet e Politikave Shëndetësore të Kosovës përcaktojnë prioritetet për kujdesin shëndetësor në Kosovë. Në qendër të sistemit primar shëndetësor, të posa zhvilluar, është koncepti i mjekësisë familjare duke ofruar Kujdes Shëndetësor Primar në Qendrat e Mjekësisë Familjare. Këto Qendra (280) janë të plotësuara nga shërbimet ambulante, nga spitalet rajonale sekondare (5) dhe nga institucioni i vetëm terciar, Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Prishtinë. Në Kosovë, aktualisht një mesatare prej 98.38 punonjës shëndetësor shërbejnë çdo 100.000 banorë në krahasim me 118.28 punonjës shëndetësor në Shqipëri dhe 219.13 në Maqedoni për çdo 100.000 banorë.

Numri i pamjaftueshëm i personelit mjekësor mendohet të ketë ndikim të konsiderueshëm në statusin shëndetësor të popullatës në përgjithësi, bashkë me shpenzimet e perceptuara të kujdesit privat, dhe të moszhvillimit të kulturës së parandalimit dhe kujdesit të vazhdueshëm shëndetësor.

Në bazë të RZHNJK 2004, Kosova ka jetëgjatësinë më të shkurtër në rajon, një situatë e cila mund ti atribuohet konfliktit të kohëve të fundit. Jetëgjatësia aktuale për femra është 69.9 vite ndërsa për meshkuj 67.8. Dallimet ndërmjet grupeve etnike nuk janë të theksuara me përjashtim të komuniteteve RAE, femrat e të cilëve kanë jetë më shkurtër sesa femrat tjera. Femrat urbane jetojnë dy vite më gjatë sesa femrat në zonat rurale.

Shkalla e Vdekshmërisë së Foshnjave është 11.1<sup>20</sup> foshnje të vdekura për 1000 lindje në krahasim me Shqipërinë me 22 dhe Kroacinë me 7.

Madhësia e familjeve në Kosovë është e lartë me rreth 6.4 persona për familje, edhe pse kjo llogaritje mund të përfshijë

20 ESK, "Statistikat e Lindjeve në Kosovë 2007", faqe 7, Qershor 2008

edhe personat e gjeneratës së tretë.

Studimi Shëndetësor dhe Demografik i Kosovës (2003) ka treguar që 35% në moshat 15-49 vjet kanë përdorur ndonjë formë të metodës kontraceptive.<sup>21</sup>

Statistikat e azhurnuara për përhapjen e HIV/AIDS është vështirë të gjenden edhe pse duket që numrat e më të rrezikuarve – seksualisht aktiv dhe përdoruesit e drogës – po rritet. Natyra e re e popullatës së Kosovës e bën këtë një shqetësim të veçantë. Njohuria për bartjen është e pamjaftueshme. DHS ka treguar një nivel relativisht të lartë të vetëdijes tek femrat në moshat 15-49 por në përgjithësi tek femrat ky nivel ka rënë në 11%. Femrat e reja në zonat urbane kanë demonstruar nivelin më të lartë të vetëdijesimit. Ka pasur korrelacion të drejtpërdrejt ndërmjet niveleve arsimore dhe niveleve të vetëdijesimit. HIV/AIDS nuk është identifikuar nga femrat e Kosovës si problem kryesor shëndetësor.<sup>22</sup>

Në një studim të bërë në vitin 2004, kanceri në gji ishte identifikuar si problemi kryesor shëndetësor te femrat shqiptare, duke i ballafaquar me shtypje të gjakut. Femrat serbe e kanë identifikuar stresin si problem kryesor shëndetësor, derisa femrat nga minoritetet joserbe kanë identifikuar problemin me shtypje të gjakut si problemin kryesor.

Femrat kanë përmendur problemet financiare, mungesën e përkrahjes nga familja dhe komuniteti si dhe mungesën e intimitetit dhe konfidencialitetit si arsye kryesore për mosqasje në kujdesin preventiv.

---

21 ESK "Situata demografike, sociale dhe riprodhuese në Kosovë", faqe 48, Korrik 2003.

22 Zëri i Femrës KWN/UNKT/KWI Kosovë (2004)

## DHUNA E BAZUAR NË GJINI

Gjatë periudhës 1989-1999, me mijëra femra janë dhunuar në mënyrë sistematike dhe të organizuar si pjesë e dhunës ndëretnike, edhe pse shumë vështrues dhe studiues të situatës kanë konkluduar se grupi më i rrezikuar për shkelje të të drejtave të njeriut në konfliktin e Kosovës ishin meshkujt e ri të “moshës luftarake”<sup>23</sup>.

Shkeljet e të drejtave të njeriut ndaj femrave dhe fëmijëve, përfshirë trafikimin dhe prostitucionin janë rritur në Kosovë gjatë viteve të fundit. Tradicionalisht, rastet e dhunës familjare dhe dhunimit kanë kaluar pa u raportuar dhe janë trajtuar si çështje private që duhet zgjidhur brenda familjes, prandaj ishte vështirë të mblidhen të dhëna statistikore të besueshme për këto raste. Sido që të jetë, studimet e bëra nga OJQ-të dhe të tjerët pasqyrojnë një eskalim të dhunës familjare siç edhe mund të pritet në situata të shkeljeve dhe varfërisë në rritje.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/1 për amendamentimin e Ligjit mbi Krimet e Ndërlidhura me Dhunën Seksuale, ka ndryshuar ligjin e aplikueshëm në fushën e dhunës martesore e cila tani është e klasifikuar si krim. Për më tepër, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/12 mbi Mbrojtjen nga Dhuna Familjare i jep gjykatave fuqi të zgjeruara për të lëshuar urdhra mbrojtës, që nuk ka ekzistuar më parë. Viktimat e dhunës familjare mund ti referohen Qendrave Komunale për Mirëqenie Sociale, të cilat pastaj do ti drejtojnë në strehimoret përkatëse.

Në aspektin e trafikimit të femrave, Kosova është kryesisht vend i destinacionit, por edhe i transitit apo originës. Një numër i grupeve të ndryshme janë përgjegjës për të reaguar ndaj kësaj çështjeje, përfshirë Njësinë për Trafikim dhe Prostitucion dhe Njësinë për Ndihmë dhe Përkrahje në UNMIK, Njësia Kundër Trafikimit me Qenje Njerëzore e SHPK-së, OSBE-ja dhe Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit.

---

23 Shuarja e Meshkujve: Gjinia, Keqprezantimi dhe Përrjashtimi në luftën e Kosovës nga Adam Jones publikuar në Tranzicione: Gazeta e Perspektivës Mashkullore 21 (2001)



## ÇËSHJET INFORMATIVE DHE SOCIO-KULTURORE

Në Kosovë, si edhe çdokund në botë, vlerat kulturore janë të theksuara si shpjegim për pabarazitë gjinore dhe në Kosovë – si edhe në vendet tjera të botës – vlerat kulturore mund të jenë mjaft rezistente ndaj ndryshimit. Po e citojmë vetëm një shembull: edhe pse meshkujt dhe femrat kanë të drejtë të barabartë në trashëgimi të tokës dhe pronave tjera, është zakon që prona familjare ti mbetet meshkujve. Dominimi i vlerave patriarkale dekurajon femrat nga kërkimi i të drejtave të tyre dhe mund ti parandaloj ato nga suksesi nëse ato vlera patriarkale mbizotërojnë sistemin juridik, edhe pse sistemi juridik i Kosovës përjashton tërësisht “vlerat” patriarkale.

Vlerat e njëjta vënë theksin edhe në preferencat ndaj djemve të dhëna në Studimin Shëndetësor dhe Demografik të Kosovës (2003) dheshpjegojnë vlerëne dhënë femrave për reprodaktivitet dhe rolin shtëpiak përballë rolit të tyre në një shoqëri të gjerë. Megjithatë, siç është theksuar më parë, shqiptarët e Kosovës po sjellin me vete përvoja dhe pikëpamje të ndryshme, që përfshijnë ide të ndryshme rreth marrëdhënieve ndërmjet meshkujve dhe femrave.<sup>24</sup> Veç kësaj, ndikimi i lartë i mediave nga shumë vende tjera në, dhe përtej Ballkanit dhe Evropës, mund të ndikojë në prezantimin e pikëpamjeve alternative të sjelljeve adekuate gjinore.

Ndryshimi i vlerave si dhe presionet ekonomike mund të jenë përgjegjës për rritjen e moshës së martesës si për meshkuj ashtu edhe për femra, që është shënuar kohëve të fundit.<sup>25</sup>

## HAPAT E PROGRESIT DREJT BARAZISË GJINORE NË KOSOVË

Në qershor të vitit 2000, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/38 ka themeluar Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë për të ruajtur dhe përkrahur respektimin e të drejtave të njeriut<sup>26</sup>.

24 Analiza Gjinore e Kosovës (2004)

25 Femrat dhe Meshkujt në Kosovë, Enti Statistikor i Kosovës, 2007

26 Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/38 për themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë.

Misioni i këtij institucioni është që të promovojë dhe të mbrojë të drejtat dhe liritë e individëve dhe entiteteve ligjore si dhe për të siguruar që të gjithë personat në Kosovë janë në gjendje që të ushtrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale në mënyrë efektive. Çështjet e diskriminimit, me baza gjinore, trajtohen nga Njësia për Barazi Gjinore në këtë institucion.

Rregullorja Nr. 2003/12 mbi Mbrojtjen nga Dhuna Familjare, e lëshuar në vitin 2003, parasheh që dhuna familjare në të gjitha format nuk do të tolerohet dhe duhet të ketë mbrojtje efektive ligjore si dhe mekanizma të ndihmës për viktimat e dhunës familjare.

Në muajin prill 2004, dy kode të reja penale kanë hyrë në fuqi në Kosovë. Neni 117 i Kodit të Përkohshëm Penal qartë e përfshin "skllavërimin", që është definuar si "ushtrim i çfarëdo kompetence ose i të gjitha kompetencave që lidhen me të drejtën e pronësisë mbi një person, duke përfshirë ushtrimin e një kompetence të tillë në trafikimin e qenieve njerëzore, veçanërisht të grave dhe fëmijëve." Gjithashtu, veprime joligjore përcaktohen dhunimi, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzënia me dhunë, sterilizimi i detyruar ose çdo formë tjetër po aq të rëndë të dhunës seksuale, si dhe persekutimi në baza gjinore. Të gjitha të lartpërmendurat janë të përcaktuara si krime ndaj njerëzimit nëse bëhen duke ditur se janë pjesë e sulmit të gjerë ose sistematik kundër popullatës civile.

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i drejton autoritetet që merren me procedura penale që "të kenë parasysh nevojat e arsyeshme të të dëmtuarve, në veçanti të...viktimave të dhunës seksuale ose gjinore" (Neni 78). Neni 90 parasheh një procedurë për të ekzaminuar një person që nuk është i pandehur "veçanërisht kur përdorimi i procedurave të tilla mund të ndihmojë në zvogëlimin e traumatizimit të mundshëm të viktimës së dhunës gjinore ose seksuale".

Përfundimisht në përputhje me nenin 517, transferi i një personi në shtet të huaj nuk mund të bëhet nëse dyshohet se transferimi kërkohet në baza gjinore. Së bashku, këto dy kode ndalojnë dhunimin martesor dhe mundohen të rregullojnë dhunën ndaj femrave në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në qershor të vitit 2004, Ligji i Barazisë Gjinore në Kosovë (LBGJ)<sup>27</sup> u shpall në bazë të të cilit është njohur barazia gjinore si vlerë fundamentale për zhvillimin demokratik të shoqërisë në Kosovë, duke ofruar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e meshkujve dhe të femrave në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore si dhe në fushat tjera të jetës.

Neni 1.1 i LBGJ-së deklaron: Barazia gjinore është e bazuar në parimet e sjelljes dhe mundësive të barabarta. Akti zbatohet përmes masave pozitive dhe politikave vetëdijësuese për barazi gjinore. Për qëllime ligjore, pjesëmarrja e barabartë tani definohet me përfaqësimin prej 40% të femrave në çdo grup apo kategori specifike.

Organet e emëruara me përgjegjësi për arritjen e barazisë gjinore përfshijnë Kuvendin e Kosovës, Qeverisë, Ministrinë dhe organet e qeverisë lokale.

Sipas Ligjit, Zyra për Barazi Gjinore është themeluar si institucion i veçantë qeveritar. Kjo zyrë është transformuar në Agjencinë për Barazi Gjinore në vitin 2006. ABGJ është përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e dispozitave ligjore, propozimin e amendamenteve në ligjet ekzistuese dhe mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve për barazi gjinore.

Ligji kërkon nga Qeveria që të hartojë Programin e Kosovës për Barazi Gjinore dhe ta dorëzojë në Kuvend për miratim. Po ashtu, në bazë të ligjit është themeluar Këshilli Ndër-Ministror për Barazi Gjinore të përbërë nga Zyrtarët për Barazi Gjinore që janë emëruar nga secila ministri.<sup>28</sup>

Zyrtarët për Barazi Gjinore janë emëruar edhe në secilën komunë. Këta zyrtarë i raportojnë Sektorit për Barazi Gjinore në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe takohen çdo muaj me Agjencinë për Barazi Gjinore. Në 20 prej 30 komunave, Komisionet për Barazi Gjinore janë themeluar me iniciativën e Kuvendeve Komunale.

Plani Kombëtar për Arritjen e Barazisë Gjinore në Kosovë është

---

27 Ligji Nr. 2004/2, Ligji për Barazinë Gjinore në Kosovë

28 Këshilli Ndër-Ministror për Barazi Gjinore është themeluar më vendim të Qeverisë Nr. 04/189 të datës 28 shkurt 2006, konform nenit 4.9 të Ligjit për Barazi Gjinore

hartuar gjatë viteve 2003-2004 si pjesë e zbatimit të Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim si dhe të CEDAW. Plani vlerëson gjashtë fusha kritike të shqetësimit (arsim, ekonomi, politikë, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, të drejta të njeriut dhe dhunë ndaj femrave, si dhe kulturë). Plani Kombëtar i Veprimit është miratuar nga Qeveria në muajin prill 2004. Në këtë sens është hartuar edhe Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2007-2013. Ky program është miratuar nga Qeveria e Kosovës me Vendimin Nr.07/17 me datë 24 prill 2008.

Për të luftuar tutje çështjet e diskriminimit të të gjitha formave, Akti kundër Diskriminimit është miratuar në shtator të vitit 2004 bashkë me një Plan të Veprimit të detajizuar për periudhën 2005-2007.<sup>29</sup> Qëllimi i Aktit është të parandalojë dhe të luftojë diskriminimin në të gjitha situatat dhe të sigurojë zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para ligjit.

Në vitin 2006, Grupi Teknik për Çështje Gjinore (GTÇGJ) është themeluar për të zhvilluar komponentën gjinore si pjesë integrale e Strategjisë dhe Planit Zhvillimor të Kosovës (SPZHK) 2007-2015.

Pavarësisht nga vendosja legjislacionit dhe institucioneve ligjore përkatëse për barazi gjinore dhe mundësi të barabartë, duhet të njihet se këto çështje nuk janë lartë në agjendën politike e cila është e dominuar nga më shumë çështje makropolitike. Megjithatë institucini më i lartë ligjvënës, Parlamenti i Republikës së Kosovës ka Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione. Njësi për barazinë gjinore ka edhe në institucionet e ndryshme jopolitke, psh. në SHPK, TMK.

---

<sup>29</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/32 për shpalljen e Akti kundër Diskriminimit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Akti i Kuvendit të Kosovës Nr. 2004/3 kundër Diskriminimit.

## SHOQËRIA CIVILE DHE GJINIA

Gjatë periudhës 1989-1998, rreth 65 OJQ kanë qenë aktive në Kosovë. Pas vitit 1999, numri i OJQ-ve të regjistruara është mbi 4500 dhe numrat kanë tendencë rritjeje. Shumë prej OJQ-ve punojnë me çështje të grave dhe disa rrjete të rëndësishme funksionojnë si organizata ombrellë për OJQ-të lokale që merren me çështje të grave. Këto përfshijnë edhe Rrjetin e Grave të Kosovës që përbëhet prej 81 grupeve të grave dhe ka për qëllim të përkrahë dhe të promovojë të drejtat e grave pavarësisht nga përkatësia politike, fetare, niveli i arsimimit, orientimi seksual dhe aftësia.

Iniciativa e Grave të Kosovës (IGK) përbëhet dhe udhëhiqet prej 35 organizatave të grave shqiptare dhe serbe. Kjo iniciativë përkrahë dhe ndërton kapacitetin e grupeve të femrave përmes Këshillave Lokale të Grave.

Lobi i Grave të Kosovës (LGK) është një grup i grave udhëheqëse, shoqërisë civile, mediave dhe fushës ekonomike që angazhohet dhe përkrahë mendimin kritik konstruktiv dhe veprimet strategjike për çështjet e grave.

## Referencat dhe burimet

Enti i Statistikave i Kosovës

Revizioni i Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor, Qendra për Studime Gjinore e Kosovës 2006

Kodi i Legjislacionit që Promovon dhe Mbron Barazinë Gjinore në Kosovë

Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit, Prishtinë, Kosovë (2007)

Shuarja e Meshkujve: Gjinia, Keqpërfaqësimi dhe Përjashtimi në luftën e Kosovës nga Adam Jones publikuar në Tranzicione: Gazeta e Perspektivës Mashkullore 21 (2001)

Analiza Gjinore e Kosovës, Sida, (2004)

Profili Gjinor i Kosovës i përgatitur për Projektin e KE "Përkrahja Metodologjike dhe Trajnimi për Barazi Gjinore në Bashkëpunim e Zhvillim" (2005)

Mozaiku i Kosovës 2006, Shqyrtimi i Shërbimeve Publike dhe Autoriteteve Lokale, UNDP/Index Kosova 2006

Rruga drejt BE-së: Monitorimi i Mundësive të Barabarta për Meshkujt dhe Femrat në Kosovë, Besim M. Kajtazi Instituti për Shoqëri të Hapur/Programi i Rrjetit të Grave (2006)

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ)

Strategjia sektoriale; Sektori për Çështje Gjinore, Strategjia dhe Plani Zhvillimor i Kosovës Plan 2007-2013, Grupi Teknik për Çështje Gjinore (2006)

Strategjia për Ngritjen e Numrit dhe të Pozitës së Femrave në IPVQ, 2006-2015, Zyra për Barazi Gjinore, Prishtinë, Kosovë (2005)

Zërat e Grave, UNKT/KWI/KWN 2004

Femrat dhe Meshkujt në Kosovë, Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, Kosovë (2007)

Rinia: një gjeneratë e re për një Kosovë të re UNDP/Raporti i Zhvillimit Njerëzor (2006)



The background features a grid of thin white lines that curve and flow from the top left towards the bottom right. The color gradient transitions from a light pink at the bottom to a soft peach or light orange at the top.

© Copyright  
Agjencia për Barazi Gjinore